



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 18.2.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë, Ganimete Musliu, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Munguan: Anton Quni, Nuredin Ibishi dhe Bojan Mitiq.

Pjesëmarrësit nga Ministria e Punëve të Brendshme: Naim Shala- drejtor i Departamentit Ligjor në MPB; Riza Shillova-drejtor i Shtyllës së Hetimeve, Policia e Kosovës; Shkodran Manaj-këshilltar politik i ministrit të MPB-së.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Skënder Perteshi-QKSS; Ardiana Gashi-OSBE; Lumnije Murati-Zyra e Presidentes së Kosovës; Krenare Loxhaj-QKSS; Blerta Bejtullahu-Zyra e BE-së; Luanda Domi-DCAF.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, fillimisht Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2.2.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;

4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke filluar me pikën e tretë të rendit të ditës dhe më pas me pikën dy dhe tre.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

Nënkryetari i Komisionit, Fadil Demaku- Filloi me pikën e tretë për shqyrtimin e Projektligjit, ku theksoi se ky projektligj është miratuar në lexim të parë në seancë ku ka pasur shumë debat. Bazuar në këtë, propozoi që deputetët të fokusohen në çështje për të cilat nuk është ngritur debat. Gjithashtu, shtoi se nga ana e z.Faton Topalli nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, janë sjellë disa propozim-amendamente, të cilat do të shqyrtohen në Komision. Më tutje, fjalën ua kaloi anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi- Theksoi se ky projektligj ka qenë edhe në mandatin e kaluar, por që për shkak procedurale nuk është miratuar, pasi është shpërbërë Kuvendi. Si Grup Parlamentar i VV-së, e përkrahim idenë që të hartohet një projektligj i tillë, por kemi vërejtje për të sidomos për disa çështje që trajtohen nga ky projektligj. Mbështes amendamentet e z.Faton Topalli për këtë projektligj. Në amendamente përshkruhet se çfarë synojmë të ndryshojmë, ku theksoi se pret një trajtim objektiv të këtyre amendamenteve nga ana e Komisionit. Me anë të këtyre propozimeve, është kërkuar që nga ana e Qeverisë të bëhet lista e organizatave terroriste. Pra, vlerësoj se e përkrah idenë që të kemi një ligj të tillë, por të jetë sa më i qartë dhe preciz, duke shpresuar që amendamentet e propozuara do të mbështeten.

Ganimete Musliu- Theksoi se pasi ky projektligj ka qenë në procedurë edhe në mandatin e kaluar, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendi nuk ka arritur që në mandatin e kaluar të miratohet. Pasi kam qenë pjesë e mandatit të kaluar, si Komision, kemi propozuar disa amendamente, të cilat tashmë janë të përfshira në projektligj, prandaj tani nuk mendoj që kam diçka për të shtuar. Prandaj, vlerësoi se nuk është e nevojshme zgjatja e procedurave apo formimi i grupit punues, në mënyrë që të procedohet më shpejt në seancë, pasi edhe ashtu është vonuar për rrethanat që jemi.

Zafir Berisha- Për projektligjin në fjalë, tha se edhe në seancë është debatuar nga deputetët dhe se ato vërejtje do të duhej të merreshin parasysh nga sponsoruesit e këtij projektligji. Gjithashtu, theksoi se ka mbrojtur qëndrimin që neni 1 i këtij projektligji të jetë më preciz, pasi përkrah idenë që të procedohet sa më shpejt ky projektligj, për shkak të rrethanave që jemi, mirëpo me

ndërhyrje dhe plotësime të këtij projektligji. Propozimin e tij do ta paraqes me shkrim dhe ky propozim do të jetë tek qëllimi i këtij projektligji, pra kur flitet për të, të precizohen luftërat terroriste që të identifikohen nga mekanizmat ndërkombëtarë, siç është OKB-ja dhe NATO-ja. Në përfundim, theksoi se edhe në Komision, edhe në Kuvend do të mbroj projektligjin që të jetë më preciz.

Qerim Bajrami- Sa i përket projektligjit, lidhur me propozimet e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, tha se i mbetet Komisionit nëse do ta aprovojë apo jo, pasi këto amendamente e ndryshojnë natyrën e projektligjit siç është aktualisht. Theksoi se duhet të jemi më të saktë për çka po flasim kur propozojmë ndryshime në të. Gjithashtu, theksoi se përkrah qëndrimin e shumicës në Komision.

Fadil Demaku- Desha të theksoj që amendamentet e propozuara nga z.Topalli, janë të shumta dhe se marrë parasysh projektligjin aktual, me pak nene që ka, pothuajse duket si një projektligj tjetër, me këto amendamente. Ndërsa, sa i përket vërejtjes së z.Berisha, theksoi se duke marrë parasysh prezencën e KFOR-it në Kosovë, d.m.th prezencë e NATO-s dhe dihet cilat janë rregullat, pra si veprohet në situata të caktuara. Konsideroi se është vendim i deputetëve të japin kontributin e tyre për të bërë plotësimin e këtij projektligji, pasi të gjithë jemi dakord për rëndësinë tij. Pasi tashmë kryetari është prezent, udhëheqjen e takimit e vazhdoi z.Daut Haradinaj.

Kryetari- Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit, të cilin do ta lexojmë nen për nen, sipas procedurave.

Rexhep Selimi- Konsideroi se për procedurë duhet të konstatohet që Komisioni e shqyrton këtë projektligj, duke mos formuar grup punues, pra kjo duhet konstatuar.

Kryetari- Theksoi se pasi që deputeti Rexhep Selimi ka ardhur pak me vonesë në Komision, në takimet e mëhershme është vendosur që trajtimi i këtij projektligji të bëhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Rexhep Selimi- Pra, të konstatojmë se po fillon puna dhe shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet sipas procedurave. Sa i përket amendamenteve, tha se nuk duhet të shihen për nga vëllimi, por për nga qëllimi dhe përmbajtja.

Ganimete Musliu- Vlerësoi se pavarësisht që përmbajtja e propozim- amendamenteve të bëra nga grupi parlamentar mund të jenë qëllimshme, mirëpo vëllimi i tyre e tejkalon pesëdhjetë për qind të keksit, dhe nëse do të përfshiheshin, projektligji do duhej të kthehej mbrapa, pra duhet të zbatohet rregullat për trajtimin e projektligjit.

Naim Shala-drejtor i Departamentit Ligjor në MPB- Theksoi se janë analizuar amendamentet e z.Topalli, por objekti i këtij projektligji nuk është terrorizmi, pasi kjo çështje është e rregulluar në Kodin penal. Fryma e këtij projektligji është kundër pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë vendit.

Kryetari- Vlerësoi se amendamentet e propozuara do të trajtohen nga ana e deputetëve dhe pasi ky projektligj është proceduar siç është tani, ne do të punojmë për të bërë më të mirën në të. Më tutje filloi leximin e projektligjit.

Rexhep Selimi- Bëri vërejtje për nenin 2, paragrafi 2 dhe 3. Për paragrafin 2. 2 kërkoi të saktësohet se kush janë ata persona. Pasi ka persona me dyshtetësi, p.sh siç janë qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë dhe njëkohësisht kanë edhe shtetësinë e Serbisë, si të veprohet ndaj këtyre rasteve? Pasi nëse lejohet kështu, përjashton nga ndjekja penale persona të tillë.

Kryetari- Vazhdoi me leximin e projektligjit. Më pas kërkoi nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së MPB-së që nëse kanë sugjerime, le të urdhërojnë.

Qerim Bajrami- Bëri vërejtje për nenin 3, pika 7, duke kërkuar të saktësohet që sipas cilit ligj apo rregullore do të arrihet ky qëllim i paraparë në këtë nen.

Riza Shillova- drejtor i Shtyllës së Hetimeve-Policia e Kosovës- Theksoi se ky projektligj është plotësim i Kodit Penal, pasi që për ta ndryshuar atë, është dashur më shumë kohë, sepse ky projektligj ka ardhur si nevojë e kohës për t'i ndihmuar organet e ndjekjes për të luftuar këtë dukuri që është shqetësuese për sigurinë kombëtare. Në vazhdim, dha sqarimet për vërejtjet e bëra nga ana e deputetëve.

Kryetari- Pas debatit për projektligjin dhe vërejtjet e bëra, fillimisht propozoi që amendamentet e propozuara të hidhen në votim, por më pas kjo çështje u shty për takimin e radhës në mënyrë që të konsultohen edhe një herë hartuesit e tyre. Me kaq e përfundoj debatin për projektligjin

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2.2.2015

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2.2.2015.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

4. Të ndryshme

Kryetari- Nëse keni çështje për diskutim, e keni fjalën.

Zafir Berisha- Theksoi se propozimin e tij për këtë projektligj, do ta sjellë me shkrim.

Rexhep Selimi- Propozoi që në njërin nga takimet e radhës, të ftohet në Komision ministri i FSK-së, lidhur me transformimin e FSK-së në FAK.

Kryetari- Theksoi se ministri dhe komandanti i FSK-së, kanë qenë në Komision në një takim njoftues dhe se janë të gatshëm të raportojnë, kurdo që do të kërkohet nga ne. Për shkak se ata

kanë qenë në vizitë jashtë shtetit, më 18 shkurt, raportimi i tyre në Komision do të vendoset në ditët në vijim.

Me këtë pikë, e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj